



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KRYETARI I KOMUNËS

14-030/01-94821/22, më 29. 04. 2022

Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/04, qershor 2008), dhe të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës nxjerr këtë

URDHËRESË

- I. NDALOHET qarkullimi i të gjitha automjeteve, përveç autobusëve të NPL "Trafiku Urban", linja 4, automjeteve të Policisë së Kosovës, të KFOR-it, të EULEX-it, të ndërmarrjes "Hortikultura", të KRM "Pastrimi", të Drejtorisë së Inspektionit dhe automjeteve emergjente, më 1 Maj 2022 për nder të Ditës Ndërkombëtare të Punës - 1 Maji, në drejtim të parkut "Gërmia", ndërsa linja 5 e transportit publik do të punojë sipas itinerarit dhe orarit të rregullt deri në Sofali.
- II. Pika përfundimtare për lëvizjen e automjeteve, përveç banorëve të lagjeve: "Normale", "Sofalia", "Tauf-Bahçe" dhe restoranteve - vilat: "Gërmia", "Freskia" dhe "Soma", do të jetë:
 - Kryqëzimi i rrugëve "1 Tetori" - "Nazim Gafurri" dhe "Ymer Lutfi Paqarizi";
 - Kryqëzimi i rrugëve "Nazim Gafurri" - "Xhavit Ahmeti" dhe "Dr. Lec Gradica";
 - Kryqëzimi i rrugëve "Dr. Shpëtim Robaj" me atë të Sofalisë, në drejtim të pishinës dhe parkut "Gërmia".
- III. Transporti publik i qytetarëve për në parkun "Gërmia" deri te pishina, do të bëhet ekskluzivisht me autobusë të NPL "Trafiku Urban", linja 4.
- IV. Inspektorët përgjegjës të Drejtorisë së Inspektionit, për datën e cekur në pikën I të urdhëresës, do të:
 - parandalojnë shërbyesit e paautorizuar që të bëjnë shitjen - shërbimin ndaj qytetarëve;

- organizojnë kujdestari, me qëllim të ruajtjes së ambientit (përdorimin e zjarreve për destinime të ndryshme), si dhe hedhjen e mbeturinave në vende të caktuara.
- V. Zyra për marrëdhënie me publikun do t'i njoftojë qytetarët dhe subjektet tjera për këtë urdhëresë, përmes mediave të shkruara dhe elektronike.
- VI. Kjo urdhëresë hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

U DORËZOHET:

- NPL "Trafiku Urban", linjat 4 dhe 5;
- Drejtorisë së Inspektionit;
- Policisë së Kosovës;
- Zyrës për marrëdhënie me publikun;
- Qendrës për shërbime me qytetarë;
- Në dosje.

KRYETARI I KOMUNËS

Përparim Rama

